

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Gratë me funde të gjata janë nëna më të mira"/ Deklarata e Tajanit shkakton zemërim në Itali, protestojn ë edhe deputetet me minifunde
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/grate-me-funde-te-gjata-jane-nena-me-te-mira-deklarata-e-tajanit-shkakton-z-i588241
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 06:52:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b20a4331907d2264a34b37ebbe65092dbedada6e2f5905add0fa67ad54290153
TEKSTI	d88814660c7218f092ebab66725cf3a8f2862c4a4c025dabc3ea9bf57a4689
PAMJA	953502ac8baac41d4f582afb8d922584bfb3f4b2da2d8340161d9388465c27

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b79368577bf368e5db72e9389bbc3c4f04a73cb416741891e8f1a8db2021e9a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	491fbc2f0e2919ed311b022f1b5f92632a55c8ad6fb3d3a6ed9398e35c5643c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7b79368577bf368e5db72e9389bbc3c4f04a73cb416741891e8f1a8db2021e9a

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Arrestohet Riccardo Bossi, djali i themeluesit të Lega-s do të vuajë 5 vjet e 9 muaj burg! Papa Leo XIV nis viziten e parë në Francë, në program edhe takimi me viktimat e a fundit

“Gratë me funde të gjata janë nëna më të mira”/ Deklarata e Tajanit shkakton zemërim në Itali, protestojnë edhe deputetet me minifunde



25 Shtator 2026, 10:00Bota TEMA

Një deklaratë e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm italian, Antonio Tajani, ka shkaktuar reagime të forta në Itali, përfshirë edhe nga Kisha Katolike.

Gjatë një konference, Tajani u pyet se çfarë këshille do t'i jepte të birit për zgjedhjen e një gruaje me të cilën të martohej. Ai tha se, ndonëse mund të ishte mirë të martohej me një grua joshëse, një grua e tillë mund të kishte pasur disa marrëdhënie, të ishte divorcuar dhe të kishte tendencë të tradhtonte.

Sipas Tajanit, ai do ta këshillonte të birin të zgjidhte një grua “më pak tërheqëse”, por më të besueshme, e cila do të ishte një nënë e mirë dhe do t'i qëndronte besnike martesës.

“Një që ndoshta vesh funde pak më të gjata se të tjerat”, tha Tajani.

Deklaratat shkaktuan reagime të menjëhershme nga politika dhe në rrjetet sociale. Disa përdorues publikuan fotografi të manipuluar të Tajanit me minifund, ndërsa deputete opozitare publikuan fotografi të tyre të veshura me funde të shkurtra.

Deputetja e Lëvizjes Pesë Yje, Chiara Apetino, publikoi një fotografi me minifund dhe reagoi me ironi ndaj ministrit.

“Tajani, a nuk jam një grua e besueshme? A nuk jam një nënë e mirë? Në vitin 2026 nuk duhet të dëgjojmë një ministër qeverie që na shpjegon se është më mirë të martohej me një grua që është më pak mbresëlënëse dhe me një fund më të gjatë. Besueshmëria jonë nuk matet me centimetra pëlhure”, shkroi ajo.

Në Senatin italian, 11 senatore të opozitës u shfaqën me minifunde në një protestë simbolike në Palazzo Madama. Ato përfaqësonin Partinë Demokratike, Italia Viva dhe Aleancën e të Gjelbërve dhe të Majtës.



Edhe ish-kryeministri Matteo Renzi reagoi ndaj deklaratave të Tajanit, duke i cilësuar ato si të papërshtatshme.

“Nuk mund të thuash që një vajzë me një fund pak më të shkurtër nuk është një person serioz. Çfarë është kjo, shekulli i 18-të?”, deklaroi Renzi, i cili kërkoi edhe shkarkimin e Tajanit nga qeveria.

Në debat u përfshi edhe Kisha Katolike. Imzot Giuseppe Baturi, kreu i Konferencës së Ipeshkvijve Italianë, tha se çdo fjalë dhe vështrim ndaj një gruaje duhet të shprehë respekt.

Shprehjet me respekt

“Çdo fjalë dhe çdo vështrim drejtuar një gruaje duhet të jetë plot respekt dhe admirim”, deklaroi Baturi.

Ai shtoi se, sipas këndvështrimit të krishterë, gruaja ka një rol të veçantë dhe se respekti është veçanërisht i rëndësishëm kur flitet për gratë.

Pas reagimeve, Antonio Tajani kërkoi falje për deklaratën e tij. Nga Nju Jorku, ku ndodhet për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, ministri italian tha se nuk kishte pasur për qëllim të ofendonte gratë.

“Kërkoj ndjesë nëse dikush është ofenduar nga ajo që thashë, por kurrë nuk kam pasur për qëllim të ofendoj gratë. Nuk e kam bërë kurrë këtë në jetën time, as në jetën time private dhe as në atë publike”, tha Tajani.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Arrestohet Riccardo Bossi, djali i themeluesit të Lega-s do të vuajë 5 vjet e 9 muaj burg

08:50 Bota

Papa Leo XIV nis vizitën e parë në Francë, në program edhe takimi me viktimat e abuzimeve nga kleri

08:40 Bota

SHBA i kthen Sirisë objekte antike të vjedhura me vlerë 5 milionë dollarë

08:20 Bota

Klassendorf: ... bezeichnet als ... die Kleinstzahl, die ... und ... enthält ...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.